

# **PLATFORME**

**e kandidimit për pozicionin e Prokurorit të  
Përgjithshëm të Republikës**



**OLSIAN ÇELA**  
**Prill 2019**

## PLATFORMË KANDIDIMI PËR PROKUROR TË PËRGJITHSHËM

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë!

Kjo platformë që po ju paraqes, përveç se mbart vizionin mbi qëllimet dhe objektivat e në ushtrimin e funksionit të Prokurorit të Përgjithshëm, është sintezë e një tërësie përvojash dhe përjetimesh të viteve në këtë profesion, personale dhe të kolegëve të mi. Platforma shpreh në mënyrë të përmbledhur pikëpamjet e atyre prokurorëve që për vite me radhë kanë kryer detyrën e tyre bazuar në vlerat më të larta morale dhe profesionale, të prokurorëve që kanë qenë të vetëdijshëm se nuk ishin duke ushtruar thjesht një profesion, por se mund të ndryshonin pozitivisht shoqërinë, të prokurorëve që janë të bindur se pavarësia mund të garantojë dinjitetin dhe përgjegjshmërinë e magjistratit, të prokurorëve që kanë besuar tek karriera e mbështetur mbi vlerat profesionale dhe intelektuale, përkushtimin dhe integritetin.

Idetë që do të parashtror në vijim, janë shprehje e aspiratës për një prokurori bashkëkohore, profesionale, efikase, që përfaqëson vlerat më të mira europiane. Ka ardhur momenti që rikonceptimit kushtetues dhe ligjor të organit të prokurorisë t'i jepet tashmë jetë përmes kontributeve individuale, përpjekjeve kolektive, bashkëveprimit e kohezionit institucional.

Kjo platformë përbën në thelb një plan strategjik, që mbart një vizion për të ardhmen e organit të prokurorisë, të mbështetur në vlerat themelore të një sistemi prokurorie europiane, parashikon veprimet konkrete në drejtim të realizimit të objektivave si dhe një sistem të vlerësimit të implementimit.

### *Gjendja aktuale*

Prokuroria ndodhet në një fazë të thellë transformimi, për shkak të ndryshimeve të rëndësishme ligjore në lidhje me organizimin e saj, të mbështetur në parimet e decentralizimit, pavarësisë dhe autonomisë së prokurorëve. Kjo fazë ristrukturimi dhe përshtatje me rregullat e reja procedurale, është shoqëruar edhe me krijimin e strukturave të reja kompetente për karrierën e prokurorëve dhe procedimin disiplinor, Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Magjistratët janë duke kaluar në procesin e rivlerësimit kalimtar, në bazë të ligjit nr.84/2016, proces i cili ka nisur të sjellë mungesa në organikën e prokurorive për shkak të largimeve të një numri të konsiderueshëm deri në këtë fazë. Përtej këtyre fakteve, hetimi në Shqipëri vazhdon të vuajë nga probleme tashmë kronike apo edhe të reja si:

- Mungesa e impaktit të hetimit dhe ndjekjes penale në uljen e kriminalitetit
- Cilësia e dobët dhe tejzgjatja e hetimeve
- Rënia e efikasitetit në përdorimin e metodave speciale të hetimit
- Numri i ulët i konfiskimeve të aseteve kriminale
- Pamjaftueshmëritë dhe përdorimi inefikas i burimeve njerëzore, financiare e teknike
- Politikat penale të paefektshme



- Moskoordinimi me shërbimet e policisë gjyqësore dhe dobësitë strukturore në organizimin e hetimit
- Besimi në rënie i publikut ndaj organit të prokurorisë
- Mungesa e transparencës
- Mosrespektimi i të drejtave të mbrojtjes
- Korrupsioni dhe problemet e etikës
- Mungesa e meritokracisë në promovimin e prokurorëve
- Mungesa e pavarësisë reale të prokurorëve
- Paqartësia në mënyrën e funksionimit të zyrave sipas ligjit të ri të prokurorisë
- Mbingarkesa në punë e magjistratëve
- Mungesa e motivimit në punë tek prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore
- Pamjaftueshmëria profesionale e policisë gjyqësore
- Mangësitë në identifikimin e nevojave specifike të trajnimeve për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore

Përveç sa më sipër, nuk ka të dhëna se cila është kostoja reale e hetimeve, cilat janë pasojat financiare dhe sociale që vijnë nga aplikimi i ekzagjeruar i dënimeve dhe masave shtrënguese ekstreme, cila është perspektiva sociale e personave të dënuar dhe e familjeve të tyre në kuptim të parandalimit të krimit, cili është niveli i respektimit të të drejtave të njeriut në fazat e para të hetimit gjatë shoqërimit në polici apo në fazat e mëtejshme etj.

Në këtë panoramë që do e cilësoja si të zymtë, nuk mund të mos spikasë roli i Prokurorisë së Përgjithshme, e cila në këtë periudhë 4-vjeçare pësoi edhe transformimin më të madh të saj, duke kaluar nga sistemi hierarkik e i centralizuar në një sistem prokurorie të decentralizuar, në themel të së cilit është pavarësia e prokurorëve dhe ku roli i saj ka ndryshuar thelbësisht.

Prokuroria e Përgjithshme, përmes një politike të paprecedentë emëtimeve, transferimesh, komandimesh, transferimesh dhe caktimesh të përkohshme të zbatuar para dhe pas ndryshimeve ligjore, përgjithësisht jashtë kriterëve të përcaktuara nga ligji, destabilizoi dhe futi në kaos sistemin e prokurorisë. Lëvizjet e shpeshta të prokurorëve krijuan probleme të mëdha në punën e zyrave, duke sjellë zvarritje të hetimeve, demotivim dhe pasiguri. Prokuroria e Përgjithshme nuk iu përshtat mjaftueshëm ndryshimeve kushtetuese e ligjore, pozicionit të ri të saj në sistemin e prokurorisë, por në mënyrë indirekte tentoi kontrollin mbi zyrat e shkallëve të para, duke çënuar hapur parimet e decentralizimit dhe pavarësisë. Përgjatë këtyre viteve ajo nuk arriti të kryejë si duhet rolin e saj kushtetues dhe dështoi të promovojë vlerat e reformës në drejtësi. Asaj i ka munguar vizioni, vullneti dhe aftësia për të ndërtuar dhe mbështetur një sistem prokurorie funksional dhe mbeti një organ me natyrë thellësisht burokratike. Gjithsesi, megjithë pamjaftueshmëritë e vëna në dukje, duhet theksuar se sektorët gjyqësorë, të marrëdhënive me jashtë dhe të përgjimeve, për shkak edhe të një tradite të konsoliduar vazhduan të performojnë mirë.



Përtej problemeve, duhet të njohim edhe vlerat që kemi e ku mund të mbështetemi për të ndërtuar të ardhmen. Në prokurori ka një gërshetim të prokurorëve të rinj, profesionalisht të aftë dhe energjikë, me prokurorë të tjerë me përvojë të gjatë në sistem e që janë një vlerë e pazëvendësueshme. Prokurorët janë më të familjarizuar me përdorimin e metodave speciale të hetimit, ndërkohë që kanë akumuluar eksperiencë në hetimin e krimit të organizuar apo krimit financiar. Bashkëpunimi me autoritetet e huaja është rritur ndjeshëm dhe ka arritur nivelet më të larta. Prokurorët kanë dëshmuar se arrijnë të kenë performancë pozitive edhe në kushtet e mbingarkesës, ndërkohë që përgjithësisht fryma e bashkëpunimit me agjensitë e tjera ligjzbatuese është e kënaqshme. Duhet evidentuar gjithashtu se trajnimi vazhdues ka dhënë efekte pozitive, pasi ka një ngritje të nivelit të prokurorëve që shfaqet në cilësinë e akteve, metodat e hetimit dhe në cilësinë e përfaqësimit të akuzës në gjyq. Një numër më i madh prokurorësh flet gjuhë të huaja dhe është i hapur ndaj ideve të reja. Përherë e më shumë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore janë të vëmendshëm ndaj respektimit të të drejtave të njeriut dhe atyre të viktimave në veçanti.

### *Çfarë synohet të realizohet*

Përcaktimi i objektivave lidhet me natyrën me përmasat e problemeve, kapacitetet njerëzore, teknike dhe financiare në dispozicion, instrumentat ligjore në fuqi që mundësojnë ndërhyrjen, nivelin e ndërgjegjësimit të vetë prokurorëve për nevojën e ndryshimeve, aftësitë përthithëse të sistemit ndaj ideve dhe metodave bashkëkohore si dhe mundësinë e përfshirjes së të gjithë elementëve institucionalë e më gjerë që kanë potencialin e duhur për të kontribuar në arritjen e tyre.

Ligji nr.97/2016 i mundëson Prokurorit të Përgjithshëm të përdorë një sërë instrumentash për të influencuar pozitivisht performancën e organit të prokurorisë, në respekt të parimeve të decentralizimit, pavarësisë dhe autonomisë së prokurorëve. Përmes tyre ai mund të krijojë sinergjinë e nevojshme brenda organit për realizimin e funksionit kushtetues. Objektivat e organit të akuzës dhe realizimi i tyre mbeten të jenë një sintezë e një tërësie kontributesh profesionale dhe përpjekjeje kolektive.

Përkundër pikëpamjes se ridimensionimi i rolit të Prokurorit të Përgjithshëm do të autë impaktin e tij në organin prokurorisë, mendoj se ndryshimi në thelb imponon një këndvështrim të ri mbi mënyrën e funksionimit të organit, kuptimin e drejtë të strukturave dhe forcave brenda tij me qëllimin implementimin e parimeve të decentralizimit dhe pavarësisë, përmes aplikimit të instrumentave efikase që do të arrijnë të sigurojnë kohezionin, bashkëveprimin dhe shfrytëzimin optimal të të gjitha kapaciteteve brenda institucionit. Realizimi i këtyre hapave, përbën në fakt edhe një nga sfidat më të rëndësishme për Prokurorin e Përgjithshëm. Ai duhet t'i mundësojë organit të prokurorisë mirëfunksionimin dhe realizimin e funksionit kushtetues përmes menaxhimit të tendencave centrifugale që janë rrjedhojë logjike e konstruktit të ri, duke kontribuar në të njëjtën kohë në garantimin e pavarësisë së prokurorëve dhe decentralizimin strukturor që është në funksion të së parës. Krijimi dhe ruajtja në vazhdimësi e këtyre ekuilibrave bën të domosdoshëm një rol aktiv të Prokurorit të Përgjithshëm, si i vetmi autoritet brenda

organit të akuzës me kompetencat dhe kapacitetet e nevojshme për të siguruar kompaktësinë e tij.

Nisur nga sa më sipër, objektivat e vendosur marrin në konsideratë jo vetëm rolin e ridimensionuar të Prokurorit të Përgjithshëm, por edhe strategjinë afatmesme të prokurorisë për vitet 2018-2020, janë komplimentare dhe e tejkalojnë atë për sa kohë lidhen me një projekt që shtrihet përtej këtyre viteve. Përmes mekanizmave që i jep ligji, Prokurori i Përgjithshëm do të jetë një kontributor i rëndësishëm dhe përcaktues në këtë ndërmarrje kolektive me objektiva si:

- Promovimi i aksionit të drejtësisë në mbrojtje të ligjshmërisë, të të drejtave të qytetarëve dhe të interesit publik
- Rritja e shpejtësisë dhe efikasitetit të hetimit në tërësinë e veprave penale përfshirë edhe identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale
- Koordinimi dhe optimizimi i bashkëveprimit mes prokurorive të zakonshme dhe Strukturës së Posaçme Antikorrupsion
- Rritja e rolit dhe efikasitetit të shërbimeve të policisë gjyqësore
- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional dhe ndërkombëtar
- Mbajtja nën kontroll dhe shpërndarja e drejtë e kostove të hetimit
- Përdorimi i ekuilibruar dhe efikas i kapaciteteve njerëzore, teknike e financiare
- Rritja e ndërgjegjësimit ndaj respektimit të të drejtave të njeriut, viktimave të veprave penale dhe të miturve
- Respektimi i të drejtave të mbrojtjes si faktor i rëndësishëm në ruajtjen e objektivitetit të hetimit dhe ligjshmërisë
- Modernizimi i sistemit të komunikimeve dhe përpunimit të informacionit
- Organizimi efikas i zyrave të prokurorisë
- Promovimi i pavarësisë së prokurorëve
- Rritja e përgjegjshmërisë së prokurorëve dhe policisë gjyqësore
- Përmirësimi i sistemit të identifikimit të nevojave të trajnimit dhe rritja profesionale e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore
- Promovimi i barazisë gjinore brenda sistemit të prokurorisë
- Rritja e transparencës ndaj qytetarëve dhe medias
- Rritja e perceptimit pozitiv të publikut për punën e organit të prokurorisë
- Ulja e nivelit të korrupsionit

Përtej këtyre objektivave, është shumë e rëndësishme që në vitet e ardhshme Prokuroria e Përgjithshme të ndryshojë rrënjësisht mënyrën e funksionimit të saj e të shndërrohet në një strukturë dinamike, inovatore, bashkëvepruese dhe bashkëpunuese. Ajo duhet të kthehet në:

- Qendër të mbledhjes, përpunimit dhe analizës së informacionit, e aftë të identifikojë tërësinë e problemeve që hasen në luftën ndaj kriminalitetit
- Entitet që është në gjendje të prodhojë ide dhe studime penalogjike e kriminologjike
- Strukturë që përçon dinamizëm brenda organit dhe katalizator të ndryshimeve pozitive, përmes:
  - ndërmarrjes së nismave për ndryshime ligjore
  - nxitjes së bashkëveprimeve efikase ndërinstytucionale



- gjenerimit të burimeve financiare me hartimin dhe propozimin e projekteve për partnerët vendas dhe të huaj

### *Veprimet konkrete*

#### Ndërhyrjet strukturore dhe planifikimi i veprimeve

Hapi i parë në funksion të transformimit të zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm është ristrukturimi i pjesshëm i saj përmes organizimit në departamente dhe ripërcaktimi i detyrave të disa prej departamenteve në funksion të realizimit të objektivave të vendosur.

1. Departamenti i Monitorimit dhe Kërkimeve Ligjore, i cili do të organizohet në dy sektorë.
  - Sektori i Monitorimit, që do të ketë në fokus monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë, përgjegjshmërinë e prokurorëve, transparencën dhe respektimin e të drejtave të njeriut, të viktimave të veprave penale, të të drejtave të të miturve, barazisë gjinore dhe diskriminimit. Për realizimin e funksioneve ai do të krijojë mekanizma komunikimi me prokuroritë e shkallës së parë dhe apeleve, Avokatin e Popullit, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe organizmat e shoqërisë civile, me qëllim shkëmbimin e të dhënave dhe identifikimin në kohë të rasteve.

Përveç rasteve kur informacioni merret në mënyrat e parashikuara nga ligji ose në mënyrë incidentare, për realizimin e këtij qëllimi, në respektim edhe të parashikimeve të nenit 28.2.gj dhe 28.2.i, ky sektor do të sigurojë dhe mbikqyrë:

- Aksesin e publikut në raport me shkeljen e të drejtave të subjekteve të procedimit penal apo në lidhje me mosrespektimin e të drejtave të njeriut.
- Monitorimin e shkeljeve të ndryshme në drejtim të zbatimit të ligjshmërisë, etikës profesionale, respektimit të të drejtave të njeriut, viktimave, mbrojtjes së të miturve etj
- Përgatitjen e raporteve vjetore mbi respektimin e të drejtave të njeriut, të drejtave të të miturve dhe viktimave në sistemin e drejtësisë si dhe përgatitjen e udhëzimeve të përgjithshme në këtë drejtim
- Fushata periodike për ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi të drejtat e tyre dhe mënyrën e aksesit në organet kompetente në rastet e pretendimeve për shkelje.
- Protokolle standarte të trajtimit të rasteve të ankesave
- Identifikimin e shkeljeve disiplinore të oficerëve të policisë gjyqësore dhe nisjen e procedurave përkatëse
- Krijimin e një sistemi elektronik të dhënash të sinjalizimit dhe raportimit të shkeljeve që lidhen me zbatimin e parimeve të transparencës dhe pavarësisë
- Rritjen e cilësisë, sasisë së informacionit dhe përditësimin e faqes online të Prokurorisë së Përgjithshme
- Publikimin e të gjitha udhëzimeve të përgjithshme në faqen zyrtare të prokurorisë



- Forcimin e marrëdhënieve me median dhe komunikimin permanent përmes publikimit periodik të raporteve për çështje me interes, me qëllim rritjen e besimit të publikut
  - Miratimi i rregulloreve mbi komunikimin me median, me qëllim rritjen e transparencës ndaj publikut dhe standartizimin e informacionit
  - Ndërtimin e një sistemi koordinimi dhe të shkëmbimit të të dhënave me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë
  - Ndërtimin e një sistemi të shkëmbimit të informacionit me Dhomën Kombëtare të Avokatisë në lidhje me respektimin e të drejtave të mbrojtjes, me qëllim evidentimin e problemeve në këtë drejtim, rasteve të mbrojtjes joefektive apo problemeve të etikës nga ana e avokatëve mbrojtës. Është e nevojshme që përmes këtij procesi apo edhe nxjerrjes së udhëzimeve të përgjithshme, të rritet ndërgjegjësimi i prokurorëve dhe policisë gjyqësore se mbrojtja është një faktor i rëndësishëm i hetimit dhe ndjekjes penale, që ndihmon në drejtim të objektivitetit të hetimit dhe ruajtjes së ligjshmërisë. Ky mekanizëm do të shërbejë në drejtim të rritjes së përgjegjshmërisë së prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe avokatëve
  - Ndërtimi i partneriteteve të qëndrueshme me organizmat e shoqërisë civile
- Sektori i Kërkimeve Ligjore do të ketë detyrë kryerjen e kërkimeve, studimeve, përgatitjen e raporteve dhe planifikimin strategjik. Brenda tij do të integrohet edhe Bordi i Organizimit të Trajnimeve. Sektori do të ketë objektiva primare veprimtari si:
- Mbledhja, përpunimi dhe analiza e informacionit statistikor
  - Përgatitja e raporteve periodike mbi gjëndjen e kriminalitetit, performancën e organit në tërësi dhe strukturave të caktuara sipas prioriteteve
  - Identifikimi i problemeve që lidhen me praktikën e hetimit, përdorimin e burimeve njerëzore, teknike dhe financiare dhe organizimin e punës
  - Draftimi i propozimeve konkrete për optimizimin e performancës
  - Identifikimi i praktikave gjyqësore unifikuese në bashkëpunim me Departamentin Gjyqësor, përgatitja e raporteve mbi çështje doktrinale dhe standartet ligjore
  - Informimi periodik online i prokurorëve mbi jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut
  - Hartimi i planeve të punës për identifikimin e nevojave për trajnim të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, përmes bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë dhe misionet ndërkombëtare për të evituar mbivendosjet në trajnime, identifikimin e nevojave reale dhe shfrytëzimin e drejtë të burimeve njerëzore dhe financiare
  - Hartimi i kalendarëve për trajnimin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, komplementarë në raport me trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës dhe organizma të tjerë
  - Konceptimin dhe bërjen funksionale të regjistrit kombëtar të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara



- Kryerja e kërkimeve dhe studimeve të ndryshme në funksion të rritjes së performancës së organit të akuzës, edhe përmes partneritetit me institucione vendase dhe misionet ndërkombëtare ku prioritare do të jenë:
  - studimi mbi koston reale të hetimeve në Republikën e Shqipërisë dhe propozime konkrete për mbajtjen nën kontroll dhe optimizimin e tyre në raport me objektivat (brenda 3 viteve)
  - hartimi i një raporti mbi gjendjen e burimeve njerëzore (prokurorë, o,p.gj, administratë), kapacitetet teknike në dispozicion, ngarkesën në punë, nevojat e riorganizimit dhe ristrukturimit të zyrave (brenda 8 muajve)
  - studim mbi efektshmërinë e hetimit, ndjekjes penale dhe sanksioneve penale, efektet sociale në shoqëri, specifikisht tek individët e dënuar dhe familjet e tyre, në këndvështrimin e hartimit të politikave të drejta për parandalimin e krimeve, (brenda 4 viteve)
  - hartimi i një raporti mbi problemet e hasura në implementimin e “sistemit të menaxhimit të çështjeve” dhe draftimi i propozimeve konkrete për përshtatjen e sistemit nevojave të organit, duke pasur pikësynim hedhjen e bazave për digjitalizimin e plotë të dosjeve penale brenda gjashtë viteve të ardhshme, me synim krijimin e një baze të dhënash të aksesueshme në kohë reale.
  - identifikimi i problemeve dhe realizimi i shortit elektronik në të gjitha zyrat e prokurorisë brenda një viti
  - përcaktimi i rregullave të qarta për mënyrën e formimit të grupeve hetimore dhe funksionimin e tyre, duke u bazuar tek shorti elektronik dhe ruajtja e pavarësisë në marrjen e vendimeve (brenda tre muajve)
- Forcimi i partneritetit përmes ndërveprimit dhe shkëmbimit permanent të informacioneve dhe raporteve me misionet ndërkombëtare në Shqipëri e më gjerë, me qëllim konceptimin, propozimin dhe përfitimin projekteve apo fondeve në funksion të realizimit të objektivave të kësaj zyre, duke e kthyer Prokurorinë e Përgjithshme në partnerin kryesor të këtyre misioneve në Republikën e Shqipërisë
- Asistimi permanent i Këshillit të Lartë të Prokurorisë me të dhëna statistikore e informacione të tjera në funksion të realizimit të qëllimit të tij

## 2. Departamenti i Koordinimit, Policisë Gjyqësore dhe Telekomunikacionit

Departamenti do të organizohet në dy sektorë:

- Sektorin e Koordinimit dhe Policisë Gjyqësore
- Sektorin e Përgjimit të Telekomunikimeve

Është e nevojshme që zyra e Prokurorit të Përgjithshëm të ndihmojë në drejtim të koordinimit të hetimeve mes prokurorive, të cilat duke vepruar në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra dhe në mungesë të strukturave ndërlidhëse, mund të hasin në vështirësi në ndjekjen e hetimeve të përbashkëta. Neni 46 i ligjit nr.97/2016, parashikon mundësinë që Prokuroria e Përgjithshme të nxjerrë udhëzime të përgjithshme të detyrueshme për koordinimin e punës mes





prokurorive të ndryshme apo mes tyre dhe policisë gjyqësore. Në këtë kuadër, duke pasur në konsideratë edhe faktin se një pjesë e madhe e veprave penale që kanë shtrirje në territor nuk do të jenë në kompetencën e SPAK, është e nevojshme ngritja e kësaj strukture e cila do të lehtësojë dhe përshpejtojë kordinimin e hetimeve. Vlen të theksohet se koordinimi do të kryhet vetëm mbi bazën e kërkesave të prokurorive përkatëse, duke respektuar parimet e pavarësisë dhe decentralizimit, ndërkohë që departamenti do të shqyrtojë edhe rastet e mosmarrëveshjeve të kompetencës.

Në këtë kuadër, një rol të rëndësishëm departamenti do të luajë në drejtim të bashkëpunimit me Strukturën e Posaçme Antikorrupsion (SPAK), duke ndihmuar në identifikimin e rasteve, koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit. Është e domosdoshme të ndërtohen mekanizma efikase të mbledhjes dhe analizës së të dhënave në shkallë kombëtare, me qëllim koordinimin e veprimtarisë së prokurorive të zakonshme me SPAK. Në funksion të këtij bashkëpunimi do të nxirren udhëzime të përgjithshme për prokuroritë e rretheve gjyqësore, bazuar edhe në marrëveshjen e arritur mes dy strukturave, e cila duhet synohet të realizohet që në momentet e para të krijimit të SPAK. Duke marrë në konsideratë faktin se një numër i madh i çështjeve do të kalojnë për kompetencë lëndore në prokuroritë respektive, është e domosdoshme të asistohet ky proces për përfundimin e tij në një kohë sa më të shkurtër.

Rolin e koordinuesit të hetimeve kjo drejtori do e kryejë edhe me organizmat e tjerë ndërkombëtarë apo autoritetet e huaja, në funksion të ndihmës reciproke apo hetimeve të përbashkëta, për të lehtësuar kontaktet dhe shkëmbimin e informacionit apo krijimin e skuadrave të përbashkëta hetimore, duke qenë se pjesa më e madhe e zyrave nuk mund të kenë kapacitetet e nevojshme për mbajtjen e këtyre raporteve edhe për shkak të mungesës së eksperiencës apo barrierave gjuhësore. Koordinimi do të kryhet në bashkëpunim me Departamentin e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, duke e lehtësuar këtë të fundit nga një pjesë e ngarkesës.

Në lidhje me Policinë Gjyqësore është e nevojshme të ritheksojmë se ajo ngelet hallkë e dobët e hetimit dhe për këtë arsye meriton një vëmendje të veçantë. Prioritet do të jetë rritja e rolit të shërbimeve të policisë gjyqësore në raport me seksionet e policive gjyqësore pranë prokurorisë, pasi Policia e Shtetit ka kapacitetet e nevojshme njerëzore, teknike e financiare për kryerjen e hetimeve. Në këtë mënyrë ekzekutivi do të marrë rolin e përgjegjësive që i takon në këtë drejtim dhe mekanizmi i bashkëveprimit mes prokurorisë dhe shërbimeve të policisë gjyqësore do të bëhet plotësisht funksional. Përcaktimi i qartë i përgjegjësive dhe përdorimi i duhur i burimeve të policisë gjyqësore do të rrisë kapacitetet e hetimit. Zbatimi i kësaj politike, monitorimi dhe koordinimi i këtij procesi, është thelbësore për ecurinë e hetimit. Për të realizuar detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 28.1.g të ligjit nr.97/2016, për drejtimin, bashkërendimin dhe mbikqyrjen e veprimtarisë së Policisë Gjyqësore, departamenti do të kryejë:

- monitorimin e ngarkesës dhe performancës së oficerëve të policisë gjyqësore
- mbikqyrjen dhe koordinimin e veprimtarisë së seksioneve të policisë gjyqësore dhe shërbimeve të policisë gjyqësore
- përgatitjen e udhëzimeve të përgjithshme në lidhje me funksionimin e policisë gjyqësore

Funksione të tjera të departamentit:

- Koordinimi i marrëdhënieve me insitucionet e tjera ligjzbatuese brenda kompetencave të zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë, Shërbimin Informativ Shtetëror, Drejtorinë e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, Agjensinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, Drejtorinë e Tatimeve, Drejtorinë e Doganave etj, me qëllim shkëmbimin e informacionit në funksion të identifikimit të nevojave për bashkëpunim, koordinimit të veprimtarive ndërinstitucionale etj.
- Mbajtja e kontakteve të përhershme me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe vlerësimin e nevojave të koordinimit të aktiviteteve.

### 3. Departamenti Gjyqësor

Me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale, roli i prokurorëve që do të përfaqësojnë çështjet pranë Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese merr rëndësi në drejtim të unifikimit të praktikave gjyqësore. Departamenti do të marrë një rol aktiv, që nis me identifikimin e praktikave të ndryshme gjyqësore dhe më pas me mbajtjen e qëndrimeve ligjore të përshtatshme. Nxjerrja e udhëzimeve për unifikimin e praktikave do të arrihet edhe përmes koordinimit të punës me Departamentin e Monitorimit dhe Kërkimeve Ligjore, i cili ka një rol përcaktues në mbledhjen dhe përpunimin e informacionit.

Departamenti do të ushtrojë një rol të rëndësishëm edhe në identifikimin e problemeve që lidhen me zbatimin e ligjit procedural penal nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, në rastet e konstatimit të akteve absolutisht të pavlefshme apo papërdorshmërisë së provave. Informacioni do të shërbejë për nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për prokuroritë ndërkohë që nëse do të jetë rasti, do t'i përcillet Sektorit të Monitorimit me qëllim vlerësimin e rastit dhe informimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për kryerjen e hetimeve për shkelje individuale. Qëndrimi rigoroz në rastet e konstatimit të këtyre problemeve do t'i shërbejë rritjes së përgjegjshmërisë së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.



### 4. Bordi Drejtues

Ky bord do të synojë koordinimin e veprimtarisë mes departamenteve, me qëllimin që progresi maksimal të arrihet në drejtim të arritjes së objektivave të institucionit. Bordi do të evitojë mbivendosjen e kompetencave mes departamenteve dhe do realizojë lidhjen funksionale mes tyre. Ai do të realizojë:

- Koordinimin dhe bashkëveprimin mes departamenteve
- Vlerësimin periodik të performancës së institucionit
- Monitorimin e zbatimit të planit të veprimit apo udhëzimeve të përgjithshme
- Diskutimin e raporteve periodike dhe vjetore të institucionit

- Koordinimin dhe mbarëvajtjen e përfaqësimit institucional me institucionet qëndrore dhe ndërkombëtare

Bordi do të funksionojë mbi bazën e mbledhjeve periodike dhe do të asistohet nga një sekretariat teknik i përhershëm që do të kryejë punën përgatitore. Mbledhja do të drejtohet nga Prokurori i Përgjithshëm, dhe bordi do të përbëhet edhe nga zv.Prokurori i Përgjithshëm të cilit mund t'i delegohet drejtimi i mbledhjes në mungesë të Prokurorit të Përgjithshëm, drejtuesit e departamenteve dhe koordinatori i bordit.

Bordi do të ketë për qëllim të zgjidhë edhe problemin që lidhet me përfaqësimin e dobët të prokurorisë në konferencat ndërkombëtare, seminarët apo takimet e ndryshme në nivel rajonal apo më gjerë. Problemet janë vërejtur në disa drejtime:

- Mungesa e informacionit të plotë mbi qëllimin e eventeve dhe nivelin e përfaqësimit
- Mungesa e kriterëve në përzgjedhjen e prokurorëve përfaqësues dhe qëndrimet që do të mbahen në raport me objektin e takimit
- Mungesa e raportimeve mbi zhvillimin e takimeve, rezultatet apo dokumentat e miratuara
- Mungesa e vijmësisë në ndjekjen e konferencave apo takimeve periodike
- Mungesa e kontributeve serioze nga përfaqësuesit dhe përfitimeve konkrete nga pjesëmarrja

Në këtë kuadër, brenda gjashtë muajve do të synohet të ndërtohet një bazë e dhënash elektronike mbi aktivitetet ku përfaqësohet prokuroria, organizmat ku është palë, aktet dhe direktivat e miratuara si dhe personat që kanë ndjekur aktivitetet apo kanë kryer përfaqësimin. Në bazën e të dhënave do të integrohen edhe dokumentat e prezantuara nga pala shqiptare, të cilat kur është e mundur do të miratohen paraprakisht nga Prokurori i Përgjithshëm.

### Masa të tjera

#### *Mbledhja periodike e drejtuesve të prokurorive (çdo katër muaj)*

1. Mbledhja do të synojë të jetë në funksion të ruajtjes së kohezionit të organeve të prokurorisë dhe do të shërbejë për:

- Identifikimin në kohë reale të problemeve që lidhen me funksionimin e zyrave
- Vlerësimin e nivelit të bashkëpunimit me institucionet e tjera
- Vlerësimin e gjendjes së hetimit, ndjekjes penale, zbatimit të ligjshmërisë dhe identifikimin e prioriteteve në luftën ndaj kriminalitetit
- Diskutimin e problemeve që lidhen me zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm
- Identifikimin e problemeve që lidhen me pavarësinë, decentralizimin, përgjegjshmërinë dhe transparencën



## 2. Përgatitja e një dokumenti konsensual me natyrë deklarative mbi gjëndjen e organit

### *Mbledhja e përvitshme e prokurorëve*

Mbledhja do të ketë për qëllim sa vijon:

- Të shërbejë si një ansamble e përgjithshme e prokurorëve dhe të jetë platforma e shkëmbimit të ideve dhe diskutimit të problemeve mbi hetimin dhe ndjekjen penale
- Përcjelljen e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave për luftën kundër kriminalitetit
- Identifikimin e problemeve që lidhen me pavarësinë e prokurorëve, funksionimin e zyrave, respektimin e të drejtave të njeriut, transparencën dhe përgjegjshmërinë
- Hartimin e një dokumenti final mbi gjëndjen e organit të prokurorisë nisur nga gjetjet e mbledhjes dhe raportet e punës vjetore të prokurorive

### *Bashkëpunimi institucional*

- Miratimi çdo vit i një dokumenti të përbashkët me Ministrin e Brendshëm dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit mbi situatën e kriminalitetit, nivelin e bashkëpunimit dhe planifikimin e masave për rritjen e performancës së policisë gjyqësore dhe hetimit në përgjithësi
- Miratimi çdo vit i një dokumenti strategjik me Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave në drejtim të rritjes së transparencës ndërinstitucionale dhe efikasitetit në hetimin e veprave penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale
- Miratimi i një marrëveshje me Avokatin e Popullit për shkëmbimin periodik të informacionit dhe hartimin çdo vit të një dokumenti të përbashkët mbi respektimin e të drejtave të njeriut nga organet e ndjekjes penale dhe masat e marra për shkeljet e konstatuara
- Miratimi i një marrëveshje me Ministrinë e Drejtësisë për përcaktimin konkret të drejtimeve të bashkëpunimit insitucional dhe miratimin çdo vit të një dokumenti të përbashkët mbi rezultatet e arritura dhe planifikimin e aktiviteteve për vitin pasardhës
- Miratimi çdo vit i një dokumenti strategjik me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për shkëmbimin periodik të informacionit dhe koordinimin e veprimtarisë

### *Marrëdhëniet me Këshillin e Lartë të Prokurorisë*

Roli i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është determinant për realizimin e funksioneve kushtetuese e ligjore të prokurorisë. Për sigurimin e mbarëvajtjes së punës, koordinimi i punës dhe shkëmbimi konstant i të dhënave mbi gjëndjen e prokurorive, ngarkesën e punës, problemet

e etikës dhe çdo aspekt tjetër të karrierës së prokurorëve si vlerësimi profesional, nevojat e transferimeve, caktimeve të përkohshme apo komandimeve, e bëjnë të domosdoshme ndërtimin e mekanizmave të qëndrueshëm që mundësojnë optimizimin e rezultatit. Për këto arsye, Prokuroria e Përgjithshme duhet të luajë një rol aktiv në mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Për realizimin e sa më sipër është e nevojshme të kryhet sa më poshtë:

- Miratimi çdo vit i një plani bashkëpunimi e bashkëveprimi mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë
- Koordinimi i aktiviteteve dhe shkëmbimi periodik i informacionit mbi problemet e natyrës organizative
- Krijimin e aksesit në kohë reale në bazën e të dhënave të prokurorisë në funksion të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë
- Asistenca permanente departamentale ndaj Këshillit të Lartë të Prokurorisë

### **Burimet**

Realizimi i planit të veprimit kërkon angazhimin e burimeve njerëzore, teknike dhe financiare. Për këtë qëllim do të vepohet si vijon:

#### **1. Burimet njerëzore**

- Plotësimi dhe rritja e numrit të prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme, duke i bazuar kërkesat mbi studime konkrete për nevojat e organit
- Komandimi i ndihmësmagjistratëve sipas parashikimeve të nenit 56 të ligjit nr.96/2016 “ Për statusin e magjistratëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (brenda 6 muajve)
- Ristrukturimi i organikave të zyrave sipas nevojave në përfundim të raportit mbi gjendjen e burimeve njerëzore (prokurorë, o,p.gj, administratë), kapacitetet teknike në dispozicion, ngarkesën në punë, nevojat e riorganizimit dhe ristrukturimit të zyrave

#### **2. Burimet financiare**

- Rritja e buxhetit të organit të prokurorisë përmes prezantimit të raporteve, analizave të detajuara mbi nevojat e rritjes së performancës dhe projekteve konkrete
- Mirëadministrimi i fondeve në dispozicion përmes rishpërndarjes së tyre sipas fushave prioritare dhe kontrollit rigoroz të shpenzimeve
- Ulja e kostove të shkaktuara nga praktikat burokratike në administrim



- Gjenerimi i fondeve nga partnerët ndërkombëtarë që ofrojnë asistencë ose përmes aplikimit në projekte të financuara nga organizmat ndërkombëtarë
- Krijimi i partneriteteve strategjike me institucionet e tjera që ulin kostot e projekteve në sajë të kontributeve të përbashkëta

### *Monitorimi*

- Realizimi i planit të veprimit do të mbikqyret periodikisht nga Bordi Drejtues
- Mënyra e monitorimit:
  - Raportet periodike të strukturave përgjegjëse të shoqëruar nga analizat financiare të kostove për projektet
  - Miratimi i raporteve periodike mbi zbatimin e strategjisë nga Bordi Drejtues
  - Raporti final

### *Përfundime*

Vlerësoj se plani i veprimit mundëson arritjen e objektivave të vendosura. Masat që do të ndërmerren, do të ndërveprojnë dhe prodhojnë efekte pozitive mbi cilësinë e hetimit dhe ndjekjes penale, do të rrisin nivelin e transparencës dhe besimit të publikut tek prokuroria, ndërkohë që do të forcojnë pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e prokurorëve. Kjo qasje e re nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, me tipare të theksuara interaktive, që sinkronizon veprimtarinë e të gjitha entiteteve brenda organit të prokurorisë dhe shërben si katalizator i koncepteve dhe metodave të reja, krijon premisat e duhura për një transformim rrënjësor të organit të akuzës, të aftë t'u përgjigjet sfidave të kohës.

Ju faleminderit!

Tiranë, Prill 2019

**OLSIAN CELA**

